



Raport Hulumtues

Strategjitë dhe Taktikat e Ndikimit të Industrisë së
Duhanit në Politikat e Shëndetit Publik në Kosovë

Prishtinë, janar 2024



Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes	2
Rreth KADC	3
Përmbledhje Ekzekutive	4
Hyrje	6
Metodologjia	9
Analiza e Përgjithshme	10
Ndërhyrja e industrisë së duhanit në sferën publike në Kosovë	10
Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike Amerikane	11
Ndërhyrjet e vazhdueshme të industrisë së duhanit në Kosovë	13
Aleanca Kosovare e Bizneseve për Udhëzimin Administrativ (UA) për Vërejtjet e Kombinuara	16
Ndërhyrja e industrisë së duhanit në politikat e akcizës së duhanit	16
Çmimi “Vangjush Gambeta” për gazetarinë ekonomike	18
Taktikat e Industrisë së Duhanit në Kosovë.....	20
Rekomandimet.....	22
Referencat	23

Rreth KADC

Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC) ka një histori të dëshmuar të avokimit për kontrollin e duhanit dhe promovimin e shëndetit në Kosovë. KADC ka punuar për të mbështetur politikat dhe zhvillimet institucionale për kontrollin e duhanit në Kosovë që nga viti 2009, duke përfshirë edhe avokimin për miratimin e një ligji gjithëpërfshirës për kontrollin e duhanit në vitin 2013. Angazhimi i KADC ka qenë thelbësor në hartimin e tij.

Lidhur me rregulloren për paralajmërimet shëndetësore për produktet e duhanit organizata KADC ka qenë aktivisht e angazhuar në politika të avokimit, kërkimit, komunikimit dhe medias. Me një përvojë të gjerë në punën dhe bashkëpunimin me institucione qeveritare, organizata të shoqërisë civile dhe komunitete ka arritur të ndërtoj koalicione dhe partneritet në mbrojtje të shëndetit publik. KADC ka punuar në mënyrë aktive në çështjet si taksat e duhanit, politikat dhe rregulloret e kontrollit të duhanit.

“Ky dokument është prodhuar me ndihmën e një granti nga Vital Strategies në emër të Bloomberg Philanthropies. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe në asnjë rast nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i qëndrimeve të donatorëve”.

Përmbledhje Ekzekutive

Raporti hulumtues ‘Strategjitë dhe Taktikat e Ndikimit të Industrisë së Duhanit në Politikat e Shëndetit Publik në Kosovë’ paraqet një analizë të detajuar të ndërhyrjes së vazhdueshme të industrisë së duhanit në politikat e shëndetit publik në Kosovë.

Në përputhje me angazhimet ndërkombëtare dhe për të përballuar sfidat specifike që paraqet industria e duhanit, Kosova në vitin 2013 ka adoptuar Ligjin për Kontrollin e Duhanit, i bazuar në parimet dhe standardet e vendosura nga OBSH. Ky ligj, përveç tjerash, synon të kufizojë ndërveprimet e qeverisë me industrinë e duhanit dhe të sigurojë transparencën në rregullimin efektiv të kësaj industrie.

Edhe pse ligji për kontrollin e duhanit është miratuar që në vitin 2013, përpjekjet e vazhdueshme të industrisë për ta dobësuar zbatimin sjellin sfida të konsiderueshme për shëndetin publik.

Në vendin tonë industria e duhanit që nga paslufta ka përdorur dhe vazhdon të përdorë taktika të ndryshme të ndërhyrjes në politikat e shëndetit publik, përfshirë lobimin tek institucionet qeveritare, ndikimin në politikat e taksave mbi duhanin dhe kundërshtimin e rregullimit të paketimeve të produkteve të duhanit.

Industria e duhanit shfrytëzon odat ekonomike, si Oden Ekonomike të Kosovës (OEK) dhe Oden Ekonomike Amerikane të Kosovës (OEAK), për të ndikuar në politikat publike, për të dobësuar dhe për të penguar zbatimin e politikave të kontrollit të duhanit që mbrojnë shëndetin e qytetarëve. Këto politika shëndetësore bien ndesh me interesat e industrisë së duhanit që synojnë të ruajnë dhe rrisin numrin e duhanpirësve dhe përfitimet ekonomike vetjake të saj.

Nëpërmjet odave ekonomike, industria e duhanit ka kërkuar ndryshime, ka kritikuar aspekte specifike dhe ka kërkuar vonim të zbatimit të politikave të kontrollit të duhanit. Nëpërmjet takimeve dhe letrave të dërguara Ministrisë së Shëndetësisë dhe ministrive e institucioneve tjera, këto oda janë përpjekur të ndikojnë në përmbajtjen dhe të zgjasin afatet kohore për implementim të udhëzimit administrativ për vërejtjet e kombinuara.

Edhe pse Udhëzimi Administrativ për Vërejtjet e Kombinuara është dashur të aprovohej që në vitin 2016, ky proces mori kohë deri në shtator të vitit 2023, kur edhe u miratua nga Ministria e Shëndetësisë. Përkundër kësaj, industria e duhanit ka vazhduar t'i kundërvihet zbatimit të këtij Udhëzimi, duke pretenduar se procesi i prodhimit është shumë i komplikuar për të përmbushur afatet e përcaktuara. Ka vazhduar të përdor argumentet e vjetra të njohura të industrisë së duhanit për rritjen potenciale të tregtisë së paligjshme, për ndikimin në ekonominë e vendit dhe paradoksalisht edhe për gjëja brengosjen e tyre për efektet negative që mund të ketë në shëndetin e konsumatorëve.

Industria e duhanit ka tentuar të ndërhyjë edhe në dispozitat kyçe të Ligjit për Kontrollin e Duhanit, sikur që është rasti kundërshtimit të nenit që ndalon shfaqjen e produkteve të duhanit në pikat e shitjes dhe rasti i ndikimit tek qeveritë e kaluara për të ndryshuar politikat e tatimeve mbi duhanin, në favor të bizneseve specifike brenda sektorit të duhanit.

Si rezultat i këtij ndikimi Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2018, kishte ulur tatimin e akcizës për produktet e duhanit dhe ndryshuar disa politika bujqësore duke favorizuar prodhimin vendas të duhanit. Këto vendime ishin anuluar nga Qeveritë e mëvonshme, në vitin 2020.

Një aspekt tjetër i strategjisë së industrisë për të shpërfaqur një imazh të favorshëm në sytë e publikut është sponsorizimi i ngjarjeve dhe çmimeve për gazetarë, si çmimi "Vangjush Gambeta". Përmes mbështetjes së shoqatave të gazetarëve dhe mediave, industria e duhanit tenton të portretizojë veten si një kontribuues në përmirësimin e lirisë së shtypit dhe zhvillimin e gazetarisë profesionale si dhe të krijoj një perceptim pozitiv nga publiku e rrjedhimisht ulë ndërgjegjësimin për rreziqet që lidhen me produktet që industria prodhon dhe shet.

Ndërveprimi i qeverisë me industrinë e duhanit, si dhe me aktorë të tjerë që mbrojnë interesat e kësaj industrie, në procesin e vendimmarrjes politike, mund të rezultojë në mbështetje dhe legjitimim të politikave pro-duhanit nga këto entitete. Kjo situatë sjell një zhvillim gradual që mund të normalizojë duhanin si një produkt të përditshëm.

Ndërveprimet mes qeverisë dhe industrisë së duhanit kanë potencialin të influencojnë mendimin publik dhe të nxisin një atmosferë ku konsumi i duhanit është i toleruar dhe miratuar nga institucionet shtetërore. Pasojat e tilla mund të jenë të rënda për shëndetin e publikut dhe për trajtimin e çështjes së duhanit si një problem social dhe shëndetësor i rëndësishëm.

Për të zvogëluar ndikimin e industrisë së duhanit dhe për të krijuar një mjedis më të shëndetshëm për qytetarët hulumtimi jep një sërë rekomandimesh. Disa nga rekomandimet përfshijnë zbatimin e politikave të mosbashkëpunimit me industrinë e duhanit, rritjen e transparencës nga dhomat ekonomike, forcimin e mekanizmave të monitorimit, rritjen e burimeve për edukimin e publikut dhe mbështetjen e grupeve të interesit.

Hyrje

Duhani, si një faktor i njohur që kontribuon në sëmundje të shumta dhe mortalitet të lartë, ka shtyrë institucionet ndërkombëtare dhe vendore të ndërmarrin masa për kufizimin e konsumit të tij. Kjo është realizuar nëpërmjet miratimit të konventave të ndryshme që synojnë mbrojtjen e shëndetit të publikut nga dëmet e duhanit. Në skenën globale, Konventa Kornizë për Kontrollin e Duhanit¹ e miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në vitin 2003, dhe direktivat e ndryshme të Bashkimit Evropian janë disa nga iniciativat kryesore që adresojnë këtë çështje. Kjo thekson nevojën për veprime të koordinuara dhe të vendosura që mbrojnë politikat e shëndetit publik nga interesat dhe ndërhyrjet e industrisë së duhanit, ashtu siç parashikohet në dokumentet kyçe të konventave ndërkombëtare.

Në përputhje me këto angazhime ndërkombëtare dhe për të përballuar sfidat specifike që paraqet industria e duhanit, Kosova ka adoptuar Ligjin për Kontrollin e Duhanit², i bazuar në parimet dhe standardet e vendosura nga OBSH. Ky ligj, i përditësuar së fundmi në vitin 2022, përveç tjerash, synon të kufizojë ndërveprimet e qeverisë me industrinë e duhanit dhe të sigurojë transparencën në rregullimin efektiv të kësaj industrie. Përveç kufizimeve ligjore, janë miratuar edhe udhëzime administrative (UA), siç është UA që rregullon mjediset pa tym duhani³ dhe UA që përcakton rregullat për vendosjen e paralajmërimeve shëndetësore në paketimet e produkteve të duhanit⁴.

Ky hulumtim synon të analizojë strategjitë e industrisë së duhanit për të influencuar politikat e shëndetit publik në Kosovë, dhe të identifikojë aktorët kyç dhe metodat që përdoren për të avancuar interesat e saj. Nëpërmjet një analize të hollësishme, zbulohen mënyrat në të cilat industria e duhanit përpigjet të ndikojë në politikat publike dhe të përforcojë rolin e saj në ekonominë vendore përkundër përpjekjeve për të kontrolluar përdorimin e duhanit për të mbrojtur shëndetin e publikut.

Ndërveprimi i qeverive me industrinë e duhanit, si dhe me aktorë të tjerë në procesin e vendimmarrjes politike, mund të rezultojë në mbështetje dhe legjitimim të politikave produhanit nga këto entitete. Kjo situatë sjell një zhvillim gradual që mund të normalizojë duhanin si një produkt të përditshëm. Ndërveprimet mes qeverisë dhe industrisë së duhanit kanë potencialin të influencojnë mendimin publik dhe të nxisin një atmosferë ku konsumi i duhanit është i toleruar dhe miratuar nga institucionet shtetërore. Pasojat e tilla mund të jenë të rënda

¹ OBSH. Konventa Kornizë për Kontrollin e Duhanit e OBSH-së. Mund të gjendet në https://treaties.un.org/doc/source/RecentTexts/FCCTC_en.pdf.

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit. 2013. Mund të gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8665>.

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2015 Mjediset Pa Tym Duhani dhe Vendosja e Shenjave për Ndalimin e Pirjes së Duhanit. 2015. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15064>

⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2023 Vërejtjet e Kombinuara. Mund të gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=82701>.

për shëndetin e publikut dhe për trajtimin e çështjes së duhanit si një problem social dhe shëndetësor i rëndësishëm. Prandaj, zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për kontrollin e duhanit dhe krijimi i një kornize ligjore të fortë janë jetike.

Në Kosovë, përdorimi i duhanit brenda kornizës së caktuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare rregullohet nga Ligji për Kontrollin e Duhanit, i miratuar në vitin 2013.

Neni 14 i këtij ligji⁵ thekson se ndërveprimet midis qeverisë dhe industrisë së duhanit duhet të kufizohen vetëm në ato të domosdoshme për një rregullim efektiv të kësaj industrie. Kur të tilla ndërveprime janë të nevojshme, qeveria duhet të garantojë transparencë të plotë. Neni 15⁶, më tej, përcakton kushtet në të cilat është e ndaluar bashkëpunimi i qeverisë me industrinë e duhanit, duke përfshirë:

- Ndalimin e partneriteteve me industrinë e duhanit që mund të interpretohen si përgjegjësi sociale;
- Refuzimin e marrëveshjeve jo të detyrueshme, memorandumet e mirëkuptimit, aranzhimet vullnetare, ose kodet e sjelljes në vend të masave ligjore të kontrollit të duhanit;
- Mospranimin e kontributeve financiare ose burimore, të drejtpërdrejta ose indirekte, ose përfshirjen në ndonjë nismë të lidhur me kontrollin e duhanit ose shëndetin publik, siç janë programet për të rinjtë dhe fushatat edukative.

Ligji, gjithashtu rregullon rrethanat në të cilat nuk lejohet pranimi i kontributeve nga industria e duhanit, përkrahja e bizneseve që i promovojnë këto produkte, privilegjimi i tyre etj. Përveç legjislacionit bazë, në Kosovë u miratuan edhe akte nënligjore për të forcuar kontrollin e duhanit. Në vitin 2015, Udhëzimi Administrativ nr. 09/2015⁷ vendosi për të siguruar mjedise pa duhan dhe për të rregulluar vendosjen e shenjave që ndalojnë pirjen e duhanit në hapësirat e mbyllura. Në vitin 2022, u miratua Udhëzimi Administrativ nr. 02/2022⁸, i cili specifikon kushtet për hapësirat e lejuara për pirjen e duhanit.

Së fundmi, në vitin 2023, u aprovua Udhëzimi Administrativ nr. 05/2023⁹ për Vërejtjet e Kombinuara. Ky udhëzim përcakton se si duhet të vendosen imazhet dhe tekstet paralajmëruese në paketimin e produkteve të duhanit për të rritur vetëdijen e konsumatorëve

⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, fq 12. 2013. Mund të gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8665>.

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, fq 12. 2013. Mund të gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8665>.

⁷ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2015 Mjediset Pa Tym Duhanit dhe Vendosja e Shenjave për Ndalimin e Pirjes së Duhanit. 2015. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15064>

⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ nr. 02/2022 Kushtet në Hapësirat e Lejuara për Pirjen e Duhanit. 2022. Mund të gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66795>.

⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2023 Vërejtjet e Kombinuara. 2023. Mund të gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=82701>.

mbi rreziqet shëndetësore. Udhëzimi synon të aplikojë vërejtje të kombinuara në të gjitha paketimet e produkteve të duhanit, përfshirë ato që tymosen, ato që nuk tymosen, dhe produktet e reja të duhanit. Përpjekjet për hartimin e këtij udhëzimi administrativ filluan që në vitin 2015, me krijimin e një grupi punues të përbërë nga Ministria e Shëndetësisë, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC) dhe partnerëve tjerë.

Ky udhëzim administrativ hyri në fuqi më 21 shtator 2023 dhe parashikon që pas gjashtë muajve nga hyrja në fuqi, të gjitha pakot e duhanit që importohen dhe prodhohen në Kosovë duhet të kenë të vendosura vërejtje të kombinuara. Një vit pas hyrjes në fuqi të udhëzimit, asnjë pako duhani në tregun kosovar nuk duhet të jetë pa këto vërejtje, që nënkupton se stoqet ekzistuese duhet të konsumohen brenda kësaj periudhe kohore. Megjithatë, afati gjashtëmuajor për vendosjen e këtyre fotografive është kundërshtuar nga Industria e Duhanit në Kosovë.

Është thelbësore të theksohet se, përtej qëllimit të saj për të rritur konsumin, ka prova që tregojnë se industria e duhanit po tenton të ruajë fitimet dhe të zgjerojë ndikimin e saj në sferat politike dhe ekonomike, duke rrezikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë shëndetin publik.

Sipas të dhënave nga Dogana e Kosovës, kosovarët konsumojnë rreth 3 mijë tonë duhan në vit në vlerë rreth 400 milionë euro. Kompanitë importuese-prodhuese të duhanit në Kosovë sipas statistikave të Doganës janë: McCroft Tobacco, Buqaj, British American Tobacco Kosovo, Prima Tobacco LLC, Gold Tobacco, Shisha Bar Noari, Gekos-Prishtinë, Puro P, Pro Atkos, Trokadero, Umpro Tobacco–Prishtinë, Kosovo Tobacco-Prishtinë, MRMW, Sirives Wine, Tilda Tobacco, Kaliman Canibe, Fm Trading, Bm Cigat, Hag Tobacco, Iglá, Gentlman Tobacco, Smox, Adalja, Caj bahce nargile dhe Tobacco Group¹⁰.

¹⁰ Adriatik Stavileci, Zëdhënës i Doganës së Kosovës. Intervista e realizuar me 1 nëntor, 2023.

Metodologjia

Në këtë hulumtim, u ndërmor një analizë thelbësore e dokumenteve dhe raporteve që lidhen me veprimtarinë e Industrisë së Duhanit, përfshirë ndikimin e saj në terren dhe vendimmarrjen qeveritare. U siguruan transkripte të Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe të Grupit Punues, ky i fundit kishte një rol kyç në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për duhanin. U realizuan intervista me zyrtarë nga Ministria e Shëndetësisë (MSH), Komisioni Ndërmintor për Kontrollin e Duhanit (KNKD), Dogana e Kosovës, deputetët e Komisionit për Shëndetësi, zyrtarë të Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MTI), dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB). Gjithashtu, u rishikuan letrat e dërguara nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës (OEAK) drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë.

Metodologjia e hulumtimit u bazua në teknikat cilësore dhe, ku ishte e nevojshme, në ato sasore. Metodatat përfshinë vëzhgimin e drejtpërdrejtë, analizën e përmbajtjes së literaturës relevante dhe intervistat e strukturuar. Për burime dytësore, u shqyrtuan studimet ekzistuese dhe hulumtimet nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare, si dhe analiza ligjore në Kosovë mbi ndikimin e industrisë së duhanit dhe konventat ndërkombëtare. Në veçanti u vlerësuan raportet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) lidhur me ndërhyrjen e industrisë së duhanit, studimet e organizatës KADC në lidhje me Ligjin për Kontrollin e Duhanit, dhe hulumtimet nga shtete të tjera si Bullgaria për të krahasuar ndërhyrjen e industrisë së duhanit në këto kontekste të ndryshme.

Analiza e Përgjithshme

Ndërhyrja e industrisë së duhanit në sferën publike në Kosovë

Politikat e kontrollit të duhanit, përveç tjerash kanë për qëllim edhe eliminimin mundësive që industria e duhanit ka për të influencuar qytetarët, veçanërisht përmes reklamave të produkteve të duhanit. Ky kontroll funksionon si një masë parandaluese kundër ndërhyrjes së industrisë së duhanit në politikat publike, duke përfshirë qeverinë, partitë politike, dhe administratën publike. Një ndër faktorët kyç që mundëson zbatim efektiv të politikave të kontrollit të duhanit është edhe parandalimi dhe kufizimi i mundësisë së industrisë së duhanit për të ndërvepruar në shoqëri.

Prapa kësaj industrie janë kompanitë që merren me prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve të duhanit. Këto kompani përdorin marketingun, kërkimin dhe zhvillimin, financat dhe shërbimet e biznesit, si dhe lobimin për të mbështetur prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve të tyre. Në Kosovë operojnë një numër mjaft i madh i kompanive, si McCroft Tobacco, Buqaj, British America Tobacco Kosovo, Prima Tobacco LLC, Gold Tobacco, Shisha Bar Noari, Gekos-Prishtinë, Puro P, Pro Atkos, Trokadero, Umpro Tobacco –Prishtinë, Kosovo Tobacco-Prishtinë, MRMË, Sirius Wine, Tilda Tobacco, Kaliman Canibe, Fm Trading, Bm Cigat, Hag Tobacco, Iгла, Gentleman Tobacco, Smox, Adalja, Caj bahce nargile dhe Tobacco Group¹¹. Disa prej tyre përveç se në Kosovë angazhohen edhe në eksportin e produkteve të duhanit në shtete të tjera.

Kosova vazhdon të përballet me sfida në përparimin e politikave të kontrollit të duhanit për shkak të ndërhyrjeve të vazhdueshme të industrisë së duhanit. Edhe pse një ligj gjithëpërfshirës për kontrollin e duhanit u miratua në vitin 2013, zbatimi i tij ka hasur vonesa për shkak të ndërhyrjeve të industrisë. Kjo e fundit, siç përshkruhet më në detaje më poshtë ka përdorur një sërë taktikash duke përfshirë kërkesat për kohë shtesë për të rishikuar rregulloret, lobimin politik dhe administrativ, promovimet dhe sponsorizimet, për të dobësuar përpjekjet për politika më të forta të kontrollit të duhanit në Kosovë. Këto taktika kanë pasur efekte negative, pasi që kanë ndikuar në vonimin e implementimit të legjislacionit për kontrollin e duhanit, siç është rasti i udhëzimit administrativ për vërejtjet e kombinuara.

Gjithashtu industria e duhanit tenton të zbeh perceptimet e zyrtarëve qeveritarë dhe publikut për efektet negative të duhanit duke ekzagjeruar rëndësinë ekonomike të kësaj industrie dhe duke injoruar kostot shëndetësore, mjedisore dhe sociale që shkakton duhani. Ata tentojnë që përmes këtyre taktikave të nxisin ndryshime ligjore për përfitime ekonomike vetjake siç është rasti i ndryshimit të vendimit për akcizën e duhanit në vitin 2018.

¹¹ Adriatik Stavileci, Zëdhënës i Doganës së Kosovës. Intervista e realizuar me 1 nëntor, 2023.

Ndërhyrja e industrisë ka ndikuar në vonimin e aprovimit të UA për Vërejtjet e Kombinuara dhe në vazhdimin e tregtimit të produkteve të duhanit pa paralajmërime të duhura shëndetësore, duke pamundësuar që popullata e Kosovës të informohet në mënyrë më të plotë për rreziqet e konsumimit të duhanit. Paralajmërimet shëndetësore përbëjnë një çështje kritike për informimin e popullatës dhe kërkojnë veprime urgjente për të çuar përpara këto politika për të mbrojtur shëndetin publik në Kosovë.

Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike Amerikane

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), përmes një letre¹² drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrisë Industrië, Sipërmarrjes dhe Tregtisë dhe Doganës së Kosovës ka dërguar vërejtje dhe mospajtime për udhëzimin administrativ për Vërejtjet e Kombinuara.

Në letrat e siguruar, thuhet që OEK ka pakënaqësi për afatin e caktuar gjashtë muaj për vendosjen e fotografive në pako të cigareve dhe madhësinë e fotografive të vendosura në pako. Po ashtu, Oda Ekonomike e Kosovës pretendon që ka mungesë të instruksioneve në lidhje me përmasat konkrete të fotove. Ndër të tjera në letër thuhet që printimi në 65% mbi sipërfaqen e pakos zvogëlon hapësirën për njoftime të tjera të detyrueshme për tu vendosur në paketim si nikotina, katrani, monoksidi i karboni etj¹³.

Po ashtu, një ndër ankesat e OEK është edhe koha e zbatimit - periudha kalimtare për importet e produkteve me paketim. Kërkesë e tyre është që periudha kalimtare të përcaktohet në 12 muaj, pasi sipas tyre për gjashtë muaj nuk mund të zbatohet procesin e gjatë të ndryshimit të paketimeve për shkak të kompleksitetit të madh teknologjik dhe procesit të prodhimit.¹⁴

Në ueb-faqen e Odës Ekonomike të Kosovës nuk mund të gjenden kompanitë e duhanit që janë anëtare të kësaj Ode. Zyrtarët e OEK, po ashtu nuk janë përgjigjur as kur janë pyetur për kompanitë e duhanit që përfaqësohen nga kjo Odë, edhe pse janë kontaktuar disa herë nga KADC.

Ndërsa, kërkesa të ngjashme drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë ka edhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK). Këta kanë shprehur shqetësime për periudhën e tranzicionit për importin e produkteve me ambalazh të ri dhe siç pohojnë mungesën e dimensioneve specifike për fotot, zvogëlimin e hapësirës për njoftimet e detyrueshme dhe afatet kohore të pa specifikuar për zbatimin e kërkesave të caktuara¹⁵.

¹² Letra e OEK dërguar Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrisë Industrië, Sipërmarrjes dhe Tregtisë, dhe Doganës së Kosovës. Tetor, 2023.

¹³ Letra e OEK dërguar Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrisë Industrië, Sipërmarrjes dhe Tregtisë, dhe Doganës së Kosovës. Tetor, 2023.

¹⁴ Letra e OEK dërguar Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrisë Industrië, Sipërmarrjes dhe Tregtisë, dhe Doganës së Kosovës. Tetor, 2023.

¹⁵ Letra e OEAK dërguar Ministrisë së Shëndetësisë. Tetor, 2023.

Oda Ekonomike Amerikane shpreh shqetësimin përkitazi siç thonë ata, me shkurtimin e periudhës së tranzicionit për importet e produkteve me ambalazhin e ri, tashmë të reduktuar në 6 muaj nga 12 muajt e propozuar fillimisht. Tutje kjo odë tërheq vëmendjen për modelet e suksesshme në BE dhe rajonet fqinje që sipas tyre, sugjerojnë një zgjatje në të paktën 15 muaj për një periudhë të mundshme zbatimi¹⁶.

Në letrën e Odës Ekonomike Amerikane tutje thuhet që për t'i adresuar shqetësime e tyre, anëtarët e OEAK propozojnë një përcaktim të qartë se cilat kërkesa të Ligjit për Kontrollin e Duhanit janë zëvendësuar nga dispozitat e UA-së. Andaj ata kanë rekomanduar nisjen e procedurës për ndryshimin e këtij ligji për qartësi dhe siguri juridike¹⁶.

Për dallim prej Odës Ekonomike të Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane në ueb faqen e saj ka emrat e anëtarëve me të cilët bashkëpunon, ku shihet se në kategorinë “Corporate” të anëtarësisë gjenden kompanitë “British American Tobacco Kosovo” dhe “Philip Morris Albania”¹⁷. Ndërsa në kategorinë “MEDIUM” gjenden kompanitë “Imperial Tobacco” dhe “Japan Tobacco International (JTI)”¹⁸.

Këto kërkesa të Odave Ekonomike në drejtim të MSh-së janë sistematike që nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ për Vërejtjet e Kombinuara, dhe më herët.

Në vitin 2018 është publikuar një raport nga Procesi i Konsultimeve për Udhëzimin Administrativ (Nrxx 2018) për Vërejtjet e Kombinuara. Ky dokument shpalos komentet e marra nga Oda Ekonomike e Kosovës-Shoqata e Prodhuesve, Importuesve dhe Distributorëve të produkteve të duhanit-(Kalo & Associates) dhe Oda Ekonomike Amerikane ndaj Ministrisë së Shëndetësisë¹⁹.

Pjesa dërmuese e komenteve që janë dërguar atëherë nga këto oda (2016) janë të ngjashme me komentet e dërguara edhe në vitin 2023.

Duket qartë se këto ndërhyrje kanë për qëllim vonimin e procesit të implementimit të vërejtjeve me fotografi duke kërkuar periudha më të gjata të zbatimit të UA në emër të proceseve të ndërlikuara teknologjike për zhvillimin e tyre, uljen e efektivitetit të vërejtjeve shëndetësore duke u ankuar se madhësia e tyre nuk lë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen informatave tjera të nevojshme në paketimin e produkteve të duhanit dhe imponimin e odave si faktor i “rëndësishëm” në hartimin dhe zbatimin e politikave të kontrollit në sytë institucioneve dhe zyrtarëve publik.

¹⁶ Letra e OEAK dërguar Ministrisë së Shëndetësisë. Tetor, 2023.

¹⁷ Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës. Ueb-faqja. <https://www.amchamksv.org/membership-directory/membership-category/corporate/>.

¹⁸ Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës. Ueb-faqja. <https://www.amchamksv.org/membership-directory/membership-category/medium/>.

¹⁹ Platforma e Konsultimeve Publike në kuadër të Qeverisë së Kosovës. Ueb-faqja. <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/40410-FinalAI.docx>.

Të dyja odat së bashku i kanë dërguar edhe një letër të përbashkët²⁰ Ministrisë së Shëndetësisë, në nëntor 2023, duke u përpjekur të ndërhyjnë sërish në procesin e implementimit të UA për vërejtjet e kombinuara. Në këtë shkresë, ato thonë se kanë për qëllim përmirësimin e punës së përbashkët “në dobi të shëndetit të konsumatorëve dhe të hyrave në buxhetin e Kosovës”²⁰, por argumentet e sjella nga ato duket se nuk i shërbejnë qëllimit të deklaruar.

Këto oda kërkojnë prapë zgjatjen e afatit të implementimit të UA për Vërejtjet e Kombinuara duke përdorur si argumente taktikat tanimë të njohura të industrisë së duhanit se si këto masa mund të ndikojnë në rritjen e tregtisë ilegale dhe ekzagjerojnë rëndësinë ekonomike të kësaj industrie duke injoruar kostot shëndetësore dhe mjedisore, citojmë:

“Nëse nuk miratohet një periudhë më e gjatë për zbatimin e këtij udhëzimi, mund të hapet rrugë për tregti ilegale, veçanërisht në sektorin e duhanit kaçak. Kjo situatë ka pasoja negative në shëndetin e konsumatorëve dhe në të ardhurat e buxhetit”²⁰ dhe “Qeveria e Kosovës është më e përfituar me mbi 65% të të ardhurave nga taksimi i duhanit. Po kështu, duhani është kontribuuesi i dytë më i madh në buxhetin e shtetit, duke dhënë një kontribut prej 281 milionë eurosh në vitin 2022”²⁰.

Ndërhyrjet e vazhdueshme të industrisë së duhanit në Kosovë

Për tendencat e vazhdueshme të industrisë së duhanit, është shprehur edhe Dr. Faik Hoti, Zyrtar Përgjegjës i grupit punues për hartimin e UA për Vërejtjet e kombinuara, sipas tij:

“Reagimet e industrisë së duhanit ndaj politikave të kontrollit të duhanit janë gjithmonë të njëjta dhe të pritshme, sepse interesat e tyre ekskluzivisht financiare, nuk përputhen me interesat legjitime të shtetit për të ulur konsumin e duhanit, që është shkaktar i dëmtimit të drejtpërdrejt të shëndetit të popullatës dhe jo vetëm. Edhe ndaj këtij UA ka pasur disa reagime, por kjo se ndalon zbatimin e UA-së dhe se përfaqësuesve të industrisë së duhanit përmes takimit informues me odat ekonomike përkatëse dhe shkresave/përgjigjeve që u janë dhënë, i është bërë e ditur se UA është në interes të shëndetit të popullatës dhe në pajtueshmëri me Ligjin për Kontrollin e Duhanit dhe me qëllimet e MSh-së, për të ulur përdorimin e duhanit në Kosovë.

Udhëzimi ka afatet e implementimit të masave dhe tashmë kanë filluar hapa konkret përgatitor nga të gjitha palët që ai të zbatohet. MSh ka vendosur në dispozicion të subjekteve ekonomike që merren me import dhe shitje të duhanit dhe produkteve të tij (përmes ueb faqes dhe formave të tjera) librarinë e vërejtjeve shëndetësore, fotot që do të vendosen në pakot e

²⁰ Letra e përbashkët e OEK dhe OEAK dërguar Ministrisë së Shëndetësisë. Nëntor, 2023.

duhanit dhe sqarimet e tjera që e bëjnë më të lehtë implementimin. Natyrisht, MSh ka obligim të lehtësojë sa më shumë procesin e implementimit, duke mbajtur një komunikim transparent me Odat ekonomike në funksion të zbatimit të Udhëzimit²¹.

Industria e Duhanit ka pasur edhe kundërshtime të tjera në të kaluarën për politikat e hartuara nga institucionet për mbrojtjet e shëndetit publik. Shoqatat e duhanshitesve në Kosovë me një peticion të nisur më 3 korrik, 2013 që zgjati deri në fund të atij viti, mblodhën rreth 10 mijë nënshkrime të qytetarëve, të mjaftueshme për të iniciuar procesin e ndryshimit të ligjit për Kontrollin e Duhanit në Kuvend. Në vitin 2014, komisioni parlamentar për shëndetësi pas një procesi votimi në këtë komision dërgoi në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim në parim propozimin për ndryshimin e nenit 9.2, bazuar nismën e organizuar nga shoqatat e duhanshitesve. Kjo nismë dështoi pasi që në Kuvend nuk u mblodh kuorumi i nevojshëm i deputetëve për shqyrtimin e kërkesës. Njëra nga deputetet e këtij komisioni që kishte votuar pro shqyrtimit të ndryshimit të nenit 9.2, votën e saj pro, e pati arsyetuar duke thënë se “Komisioni është dashur të shqyrtojë nismën për ndryshimin e Ligjit për Duhanin, pasi që është obligim kushtetues që komisioni kërkesën me peticion ta procedojë në Kuvend”²².

Kundër kësaj iniciative kishte ka pasur një reagim të fuqishëm nga Koalicioni Anti Duhan i Kosovës, me 3 maj të vitit 2014. Ky koalicion që përfaqëson më shumë se njëzet subjekte qeveritare dhe joqeveritare dhe përfaqësues edhe të organizatave ndërkombëtare në Kosovë (MSh, OBSH, KADC) u shpreh kategorikisht kundër çfarëdo ndryshimi në Ligjin për Kontrollin e Duhanit. Koalicioni po ashtu u bëri thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të mos i nënshtrohen presionit të industrisë së duhanit, për të ndryshuar nenin 9.2 të këtij ligji, i cili ndalon paraqitjen apo ekspozimin e produkteve të duhanit në pikat e shitjes²³.

Për Koalicionin Anti-Duhan ka qenë shqetësues nxitimi i disa deputetëve të Kuvendit të Kosovës që nën presionin e industrisë së duhanit, të vendosin për shqyrtim në parim propozimin për ndryshimin e nenit 9.2 bazuar në një nismë qytetare të industrisë së duhanit, të nisur pa u bërë as dy muaj të plotë (korrik, 2013) të fillimit të zbatimit të ligjit dhe pa kryer asnjë hulumtim rreth efekteve të këtij neni²³.

Ndërhyrjet e industrisë së duhanit ishin shumë intensive që nga fillimi i procesit të hartimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit. Në debatin e organizuar nga Komisioni Parlamentar për Shëndetësi për Projekt Ligjin për Kontrollin e Duhanit, në nëntor të vitit 2012, kompanitë kryesore të industrisë së duhanit kundërshtuan publikisht masat e kontrollit që parashiheshin me këtë projektligj.

²¹ Intervistë me Dr. Faik Hoti, Zyrtar Përgjegjës i Grupit punues për hartimin e UA për Vërejtjet e kombinuara. 25 tetor, 2023.

²² Gazeta Kallxo.com. Betejë në Kuvend për Ekspozimin e Sërishëm të Duhanit. 21 prill, 2014.
<https://kallxo.com/gjate/beteje-ne-kuvend-per-ekspozimin-e-serishem-te-duhanit/>.

²³ Ekonomia.Info. Kundërshtohet ndryshimi në Ligjin për Kontrollin e Duhanit. 3 maj, 2014.
<https://ekonomia.info/sq/shendetesi/kundershtohet-ndryshimi-ne-ligjin-per-kontrollin-e-duhanit>.

Andi Nano, përfaqësues i “Japan Tobacco International (JTI)” tha që JTI-ja nuk është absolutisht dakord me mos lejimin e ekspozimit të produkteve të duhanit në pikat e shitjes. Nuk ka asnjë lloj prove të besueshme për të justifikuar ndalimin e ekspozimit të produkteve të duhanit; dhe kjo do të kishte pasoja serioze negative dhe me shtrirje të gjerë mbi konkurrencën, konsumatorët, shitësit me pakicë dhe tregtinë e paligjshme²⁴.

Të njëjtin shqetësim pati shprehur edhe Elton Stefani në emër të “Philip Morris International Management S.A.” Ai ka shprehur shqetësimet që kanë të bëjnë më shumë me pajtueshmërinë ligjore të dy prej neneve të projektligjit për kontrollin e duhanit [9.2.] ndalimin e ekspozimit në pikën e shitjes të produkteve të duhanit, që mbështetet në analizën ligjore të kryer nga “Kalo & Associates” Kosovë²⁴.

“Neni tjetër për të cilën “Philip Morris International” paraqet shqetësim, është neni 15 i cili parasheh ndalimin e komunikimit dhe bashkëpunimit midis Industrisë dhe Autoriteteve Shtetërore. Këto shqetësime do t’i paraqes si më poshtë. Futja e ndalimit të ekspozimit në pikën e shitjes për produktet e duhanit në Republikën e Kosovës ngrit një numër të çështjeve ligjore nga këndvështrimi i Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”²⁴, tha Stefani.

Edhe Ilda Kokona nga “British American Tobacco” duke u angazhuar për aprovimin e ligjit në parim ka shprehur mospajtimet e kësaj industrie lidhur me disa nga zgjidhjet e propozuara në projekt ligj. Po ashtu edhe nga “Imperial Tabacco” e komentuan draft ligjin si rigoroz për ambientin e Kosovës dhe si ndikues jo i mirë në ekonomi²⁴.

²⁴ Ekonomia.Info. Industria e duhanit kundër Ligjit për kontrollin e Duhanit. 20 nëntor, 2012. [Industria e duhanit kundër Ligjit për kontrollin e Duhanit - Industri - Ekonomia.](#)

Aleanca Kosovare e Bizneseve për Udhëzimin Administrativ (UA) për Vërejtjet e Kombinuara

Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve gjatë një interviste në kuadër të këtij hulumtimi ka thënë që sektori i duhanit është një nga sektorët që sjell më së shumti fitime sa i përket financave, andaj ka rekomanduar që implementimi i Udhëzimit Administrativ për Vërejtjet e Kombinuara të shtyhet²⁵.

“UA që hyn në fuqi për gjashtë muaj për cigaret që hyjnë me import dhe një vit për ato që prodhohen këtu, ne kemi rekomanduar që kjo të mos ndodh, të shtyhet së paku për një vit implementimi i saj por nuk e di a do të përfillet kjo nga Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës. Sektori i importit të duhanit është një nga sektorët që sjell shumë në aspekt financiar, po në aspekt shëndetësor dihet ma që është i dëmshëm. Por prapë se prapë Kosova e ka humbur një fuqi të importit të cigareve në momentin kur ka rrit akcizën pothuajse më të shtrenjtën në Ballkan. Udhëzimi i ri i cili parasheh 60% për të mbuluar pakon e cigares është një kërkesë pothuajse jashtë standardeve të Evropës dhe kjo do të kushtojë do të rrit koston e cigareve se paku për dhjetë cent, sidomos pas vitit të ri kur pothuajse duhet të hyjë në funksion UA. Po ashtu ndikimi për të ulur pirjen e duhanit kjo nuk do të ndikojë, për arsye se duhanpirësit do të vazhdojnë të konsumojnë produktin e vet të preferuar dhe ma shumë e shoh ngarkesë për importues se sa lehtësira”²⁵.

Ndërhyrja e industrisë së duhanit në politikat e akcizës së duhanit

Qeveria e Republikës së Kosovës me 9 tetor, 2018 ka nxjerrë Vendimin Nr.11/68²⁶ për plotësimin e Vendimit Nr. 11/64²⁷, të datës 16 dhjetor, 2015 për tatimin e akcizës në duhan.

Sipas kalendarit të akcizës që parashihej në vendimin e vjetër të vitit 2015, norma e tatimit të akcizës për cigare që përmbanin duhan në vitin 2016 do të ishte 41 euro për kilogram, dhe për secilin vit deri në vitin 2019 do të shtrenjtohej për nga dy euro për kilogram²⁸. Kjo nënkupton se vlera e tatimit të akcizës së cigareve për vitin 2018 ishte 45 euro për kilogram.

Por në Vendimin²⁹ e ri me 9 tetor, 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës e shtoi edhe një pikë sipas së cilës norma e tatimit të akcizës për cigaret e prodhuara në Kosovë përllogaritet duke përdorur metodën sipas vlerës (ad valorem) dhe përllogaritja bëhet në çmimin e shitjes me pakicë me normë 30 përqind (30%) në vlerën e shitjes me pakicë. Nëpërmjet këtij vendimi, vlera e tatimit të akcizës për cigaret e prodhuara në Kosovë do të ishte dukshëm më e ulët –

²⁵ Intervistë me Agim Shahini, Kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve. 10 nëntor, 2023.

²⁶ Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi Nr. 11/68. 9 tetor 2018. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62513> .

²⁷ Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi Nr. 11/64. 16 dhjetor, 2015. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62544> .

²⁸ Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi Nr. 11/64. 16 dhjetor, 2015. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62544> .

²⁹ Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi Nr. 11/68. 9 tetor 2018. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62513> .

rreth 27 euro për kg³⁰ (nëse merret vlera mesatare e shitjes me pakicë në atë kohë - 1.8 euro për një pako cigare) se sa vlera e tatimit të akcizës prej 45 euro për kg që paguhej për cigaret tjera.

Nga ky vendim përfituesi më i madh ishte nënkryetari i partisë qeverisëse të Republikës së Kosovës, i cili në vitin 2018 mbante edhe pozitën e Koordinatorit për Zhvillim Ekonomik në Qeveri. Kjo, pasi që fabrika e vetme që merrej me prodhimin e cigareve në Kosovë ishte “Premium Tobacco Group”, në bashkëpronësi të tij³¹.

Vendimi Nr.11/68³² i datës 9 tetor, 2018, është shfuqizuar dy vite më vonë nga Qeveria e mëvonshme³³. Fillimisht Ministri i Financave i kësaj qeverie ka deklaruar se është konstatuar se ky vendim është i dëmshëm për shtetin prandaj duhet të shfuqizohet menjëherë. Sipas tij edhe zyra e Bashkimit Evropian ka kërkuar që mos të hyjë në fuqi ky vendim. “Ky koncept që ne dëshirojmë të shfuqizohet e ka ndryshuar numrin e akcizës dhe këto nuk janë të drejta. Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ka kërkuar që mos të hyjë në fuqi pasi bien në kundërshtim me rregullat”³⁴.

Në vitin 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës shfuqizoi edhe Vendimin me Nr. 20/64³⁵ të datës 11 shtator, 2018 sipas të cilit aprovohej Koncept-Dokumenti për Ndryshimin e Politikave Fiskale për Prodhimin e Duhanit dhe Cigareve në Kosovë³⁶. Ky koncept dokument i kishte hapur rrugë vendimit që zvogëlonte vlerën e tatimit të akcizës për cigaret e prodhuara në Kosovë.

Për vendimet e Qeverisë Nr. 20/64 të datës 11 shtator, 2018 dhe Nr.11/68 të datës 9 tetor, 2018, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK)³⁷ në vitin 2019 ka pranuar një kërkesë për shqyrtim të konfliktit të mundshëm të interesit. Kryetari i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes i ishte drejtuar Agjencisë Kundër Korrupsionit, me një kërkesë për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me nxjerrjen e vendimeve të mësipërme nga Qeveria e Republikës së Kosovës, pasi që përfitues nga këto vendime të qeverisë po del të jetë biznesi “Premium Tobacco Group”, që është në bashkëpronësi të një zyrtari të lartë të partisë së Kryeministrit, që njëkohësisht është edhe këshilltar i tij³⁸.

³⁰ Shënim i autorit.

³¹ Insajderi. Shfuqizohet vendimi për akcizën e duhanit me të cilin përfitonte Gazmend Abrashi. Viti 2020.

<https://insajderi.com/shfuqizohet-vendimi-per-akcizen-e-duhanit-me-te-cilin-perfitonte-gazmend-abrashi/>.

³² Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi nr. 20/64. 11 shtator, 2018. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62509>.

³³ Kallxo.com. Albin Kurti ndalon favoret për kompaninë e këshilltarit të Ramush Haradinajt. 28 shkurt, 2020.

[Albin Kurti ndalon favoret për kompaninë e këshilltarit të Ramush Haradinajt \(kallxo.com\)](http://AlbinKurti.ndalon.favoret.për.kompaninë.e.këshilltarit.të.Ramush.Haradinajt.kallxo.com).

³⁴ Ekonomia Online. Qeveria shfuqizon vendimin që favorizonte ish-këshilltarin e Haradinajt. Viti 2020. Mund të gjendet në

<https://ekonomiaonline.com/qeveria-shfuqizon-vendimin-qe-favorizonte-ish-keshilltarin-e-haradinajt/>.

³⁵ Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi nr. 20/64. 11 shtator, 2018. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62509>.

³⁶ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. KONCEPT DOKUMENTI PËR NDRYSHIMIN E POLITIKAVE FISKALE DHE BUJQËSORE PËR PRODHIMIN E DUHANIT DHE CIGAREVE NË KOSOVË. 1 gusht, 2018. <https://www.mbpzhr-ks.net/sq/ligjet>.

³⁷ <https://akk-ks.org/>

³⁸ Agjencia Kundër Korrupsionit. Përgjigja në kërkesën e z. Glauk Konjufca për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Nr. protokollit 06-02/1348/19. 4 korrik, 2019.

Në përgjigjen e saj AKK konstaton se edhe “se përfitues i kësaj politike të qeverisë në nivel vendi, aktualisht po del të jetë një biznes në të cilin bashkëpronar është një zyrtar i lartë nga partia e Kryeministrit, atëherë kjo nuk do të thotë ‘apriori’ se është konflikt faktik i interesit. Mund të konsiderohet si konflikt në dukje, por konflikti në dukje jo gjithmonë dhe jo domosdoshmërisht është edhe konflikt i interesit”³⁸.

Në arsyetimin e saj se pse kjo çështje nuk është konflikt faktik, AKK thotë se “vendimi, nuk është vendim individual, vendimi nuk i dedikohet personit konkret, sikurse që vendimi nuk i dedikohet as biznesit konkret”³⁸.

Pra, në përgjigjen e saj, AKK, nuk e kishte mbështetur pretendimin e shtruar, me argumentet se në këtë rast kemi të bëjmë me vendimmarrje kolektive, dhe se efekti i kësaj vendimmarrjeje nuk është i dedikuar as individual, as përjashtues e favorizues, por është gjithëpërfshirës për gjithë Republikën e Kosovës³⁸.

Çmimi “Vangjush Gambeta” për gazetarinë ekonomike

Çmimi “Vangjush Gambeta” ndahet çdo fund vit nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë (UGSH). Ceremonia e ndarjes së çmimeve ekonomike “Vangjush Gambeta” filloi në vitin 2009³⁹ dhe mbështetet financiarisht nga kompania “Japan Tobacco International (JTI)”⁴⁰.

Në ceremonitë tradicionale marrin pjesë gazetarë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Lugina e Preshevës. Në edicionin e vitit 2023 të ndarjes së çmimeve mori pjesë edhe presidenti i Republikës së Shqipërisë Bajram Begaj⁴¹.

Në ceremoninë e edicionit të vitit 2023, të pranishmeve iu drejtua edhe drejtori i JTI për Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut, Sazan Alija. Ai vlerësoi lartë punën dhe angazhimin e gazetarisë ekonomike dhe theksoi “se puna juaj është thelbësore në rritjen e transparencës së institucioneve shtetërore si dhe në krijimin e një konkurrence të ndershme për bizneset, në veçanti lidhur me ‘fiskalizimin’ ose përpjekjet që bën shteti kundër evazionit fiskal në ekonomi”⁴¹. Alija, gjithashtu theksoi se “përveç përkrahjes së çmimeve Vangjush Gambeta, JTI ka mbështetur veçanërisht gazetarinë ekonomike duke përkrahur dhe mundësuar pjesëmarrjen e tyre në Kongresin e Gazetarisë në Vjenë, Samiti i ministrave të financave, guvernatorëve të bankave qendrore dhe administratave tatimore në Malin e Zi dhe ngjarjet tjera, me një qëllim qartë – të rriten praktikat rajonale për mirë qeverisje, sundim të ligjit dhe ekonomi tregu të lirë”.

³⁹ Unioni i Gazetarëve Shqiptarë. Dritëro Agolli merr “Pendën e Artë” për gazetarinë. Paragrafi i pestë. 18 shkurt, 2017. <https://unionigazetareve.com/index.php/2017/02/18/dritero-agolli-merr-penden-e-arte-per-gazetarine/>.

⁴⁰ Gazeta “Epoka e Re”. Ndahen çmimet Vangjush Gambeta për gazetarinë ekonomike. 10 nëntor, 2023. <https://www.epokaere.com/ndahen-cmimet-vangjush-gambeta-per-gazetarine-ekonomike/>.

⁴¹ Gazeta “Epoka e Re”. Ndahen çmimet Vangjush Gambeta për gazetarinë ekonomike. 10 nëntor, 2023. <https://www.epokaere.com/ndahen-cmimet-vangjush-gambeta-per-gazetarine-ekonomike/>.

Në ceremoninë e njëjtë kryetari i UGSH Aleksander Çipa i ndau mirënjohje JTI partnerit tradicional i cili për 15 vite ka mundësuar konkursin për çmimin Vangjush Gambeta. Në mirënjohjen e UGSH për JTI "Përmes bashkëpunimit dhe partneritetit të JTI me UGSH është bërë i mundur inkurajimi për raportim cilësor dhe të thelluar në hapësirën mediatike shqiptare për çështje të ekonomisë"⁴¹.

Kryetari i UGSH, Aleksander Çipa theksoi se duke i falënderuar JTI për të 15 herë janë duke u ndarë çmimet Vangjush Gambeta dhe se gjatë viteve në konkursin për çmime marrin pjesë edhe gazetarët nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut⁴¹.

Përmes përkrahjes për shoqatat e gazetarëve, siç është rasti i çmimit "Vangjush Gambeta", industria e duhanit përpiqet të shfaqet si një sektor me përgjegjësi sociale korporative (CSR). Për këtë arsye, ajo ka zgjedhur që të mbështesë shoqatat e gazetarëve dhe mediave, duke tentuar të portretizojë veten si një kontribuues në përmirësimin e lirisë së shtypit dhe zhvillimin e gazetarisë profesionale.

Kjo përpjekje për të treguar angazhimin e saj në përmirësimin e lirisë së shtypit dhe zhvillimin e gazetarisë profesionale është një aspekt i strategjisë së tyre për të shpërfaqur një imazh të favorshëm në sytë e publikut. Përmes kësaj "CSR të rreme," industria e duhanit përpiqet të krijoj një perceptim pozitiv nga publiku dhe të ulë ndërgjegjësimin për rreziqet që lidhen me produktet që ata prodhojnë dhe shesin.

Duke ofruar mbështetje financiare për shoqatat e gazetarëve, industria e duhanit përpiqet të sigurojë një platformë për komunikim që mund të përdoret për të formuar një narrativë të favorshme lidhur me rolin e tyre në shoqëri. Megjithatë, është thelbësore të kuptohet se ky angazhim është pjesë e një përpjekjeje për të ndikuar në opinionin publik dhe për të penguar kritikën ndaj industrisë së duhanit dhe rreziqeve që shkakton përdorimi i duhanit.

Taktikat e Industrisë së Duhanit në Kosovë

Të gjeturat më lartë tregojnë qartë për një angazhim të vazhdueshëm të industrisë së duhanit në Kosovë për të mbrojtur interesat e saj komerciale dhe për të penguar ose ngadalësuar zbatimin e politikave që synojnë të reduktojnë konsumin e duhanit dhe të mbrojnë shëndetin publik. Kjo industri vazhdimisht përpiqet të ndikojë në proceset vendimmarrëse duke përdorur palët e treta si odat ekonomike për të influencuar ndryshimin e politikave anti-duhan në favor të saj. Përmes përkrahjes për shoqatat e gazetarëve, industria e duhanit përpiqet të shfaqet si një sektor me përgjegjësi sociale korporative (CSR). Për këtë arsye, ajo ka zgjedhur që të mbështesë shoqatat e gazetarëve dhe mediave, duke tentuar të portretizojë veten si një kontribuues në përmirësimin e lirisë së shtypit dhe zhvillimin e gazetarisë profesionale.

Qëllimi këtyre taktikave të industrisë së duhanit, në parim është rritja dhe ruajtja e përfitimeve të veta ekonomike pavarësisht kostove shëndetësore, mjedisore dhe sociale që shkakton kjo industri. Taktikat e industrisë së duhanit mund të përmbliidhen si më poshtë:

- **Lobimi te Institucionet Qeveritare:** Kanë dërguar letra dhe kanë zhvilluar takime me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucione të tjera për të shprehur pakënaqësitë dhe mospajtimet me rregullore të caktuara.
- **Përpjekjet për Shtyrjen e Afateve:** Kanë kërkuar shtyrje të afateve për zbatimin e rregulloreve të reja, veçanërisht për vendosjen e fotografive paralajmëruese në paketimet e cigareve dhe madhësinë e tyre.
- **Kritikat ndaj Rregulloreve:** Kanë kritikuar mungesën e qartësisë dhe instruksioneve specifike në lidhje me përmasat dhe vendosjen e fotografive në paketimet e cigareve.
- **Ankesat për Procesin e Ndërlikuar të Prodhimit:** Kanë argumentuar se procesi i ndryshimit të paketimeve është shumë i ndërlikuar dhe nuk mund të realizohet brenda periudhës së caktuar prej 6 muajsh.
- **Shqetësimet mbi Tregtinë Ilegale:** Kanë shprehur shqetësimin se periudhat e shkurtra të tranzicionit mund të inkurajojnë tregtinë ilegale, duke pasur efekte negative në shëndetin e konsumatorëve dhe të ardhurat e buxhetit.
- **Argumentet për Shëndetin e Konsumatorëve:** Kanë theksuar rrezikun më të madh për shëndetin e konsumatorëve nga produktet e pakontrolluara dhe përdorimi i mundshëm i duhanit të hapur për të përzier me substancat tjera të dëmshme.
- **Argumentet Ekonomike:** Kanë theksuar se duhani është një burim i rëndësishëm i të ardhurave për buxhetin e Kosovës, me një kontribut të konsiderueshëm.
- **Rezistenca ndaj Rregulloreve të Paketimit:** Kanë argumentuar kundër dispozitave që detyrojnë vendosjen e paralajmërimeve figurative në paketimin e duhanit, duke pohuar se nuk janë efektive në uljen e pirjes së duhanit.
- **Kërkesa për Përcaktim të Qartë të Ligjit:** Kanë kërkuar ndryshime në legjislacion për të pasur më shumë qartësi dhe siguri juridike.

- **Përdorimi i Palëve të Treta për Lobim:** Përdor palët e treta si odat ekonomike për të ndikuar në proceset vendimmarrëse dhe për të influencuar ndryshimin e politikave anti-duhan në favor të saj.
- **Përfitimet nga Rregullat e Tatimit:** Kanë përfituar nga vendime të qeverisë që kanë ulur akcizën për produkte të caktuara të duhanit.
- **Përpjekjet për të Ndikuar në Politikat Bujqësore:** Kanë ndikuar në politikat që favorizojnë prodhimin e duhanit në vend.
- **Sponsorizimi i Eventeve dhe Çmimeve për Gazetarët:** Përmes sponsorizimit të ngjarjeve dhe çmimeve për gazetarët, përpiqet të portretizojë veten si një kontribuues në përmirësimin e lirisë së shtypit dhe zhvillimin e gazetarisë profesionale, dhe të shfaqet si një sektor me përgjegjësi sociale korporative (CSR). Në këtë mënyrë përpiqet të sigurojë një platformë për komunikim që mund të përdoret për të formuar një narrativë të favorshme lidhur me rolin e tyre në shoqëri.

Rekomandimet

Masat që ndihmojnë në krijimin e një mjedisi më të shëndetshëm për qytetarët dhe do të kufizojnë ndikimin e dëmshëm të industrisë së duhanit në politikat shëndetësore të Kosovës:

- **Refuzimi i Bashkëpunimit me Industrinë e Duhanit:** Qeveria të ndërmarrë një politikë të qartë të refuzimit të bashkëpunimit me industrinë e duhanit dhe përfaqësuesit e saj, sidomos në fushat që kanë të bëjnë me implementimin e politikave të shëndetit publik, sponsorizimet dhe mbështetjen financiare.
- **Transparenca nga Odat Ekonomike:** Odat Ekonomike të bëjnë publike emrat e anëtarëve dhe lidhjet e tyre me industrinë e duhanit, duke rritur kështu llogaridhënien dhe transparencën.
- **Forcimi i Mekanizmave Monitorues:** Shtimi i burimeve dhe stafit për inspektorate si Inspektorati i Tregut dhe Inspektorati Sanitar, për të garantuar zbatimin e rreptë të ligjeve dhe rregulloreve në lidhje me duhanin. Ngritja e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Ministrisë së Shëndetësisë, dhe inspektoratit të tregut për një mbikëqyrje më efektive të zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit.
- **Mbyllja e Zbrazëtirave Ligjore:** Mbyllja e zbrazëtirave ligjore dhe krijimi i një kodi të sjelljes për zyrtarët publikë që kanë të bëjnë me industrinë e duhanit.
- **Edukimi i Ligjvënësve:** Zhvillimi i programeve të edukimit për ligjvënësit në lidhje me taktikat e industrisë së duhanit dhe ndikimin e saj në politikat shëndetësore.
- **Pavarësia Financiare për Çmime:** Sigurimi i pavarësisë financiare për çmimet si "Vangjush Gambeta" duke eksploruar burime të financimit që nuk janë të lidhura me industrinë e duhanit dhe duke bërë transparente proceset e sponsorizimit.
- **Shtimi i Resurseve për Edukim Publik:** Vazhdimi i fushatave të edukimit publik për dëmet e duhanit dhe për praktikën e industrisë së duhanit, duke përdorur media dhe programe në shkolla për të ndaluar fillimin e duhanpirjes në moshë të re.
- **Mbështetje për Grupet e Interesit:** Fuqizimi i koalicionit anti-duhan dhe mbështetja e grupimeve të interesit që luftojnë kundër duhanpirjes, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe shoqërinë civile.
- **Kufizimi dhe Rregullimi i Lobimit:** Vendosja e kufizimeve të qarta për lobimin e industrisë së duhanit dhe parandalimi i ndikimit të saj në procesin e politikë-bërjes.

Referencat

- OBSH. Konventa Kornizë për Kontrollin e Duhanit e OBSH-së.
https://treaties.un.org/doc/source/RecentTexts/FCTC_en.pdf .
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit. 2013.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8665> .
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2015 Mjediset Pa Tym
Duhanit dhe Vendosja e Shenjave për Ndalimin e Pirjes së Duhanit. 2015.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15064> .
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2023 Vërejtjet e
Kombinuara.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=82701> .
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, fq 12.
2013. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8665> .
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, fq 12.
2013. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8665> .
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ nr. 02/2022 Kushtet në
Hapësirat e Lejuara për Pirjen e Duhanit. 2022.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66795> .
- Adriatik Stavileci, Zëdhënës i Doganës së Kosovës. Intervista e realizuar me 1 nëntor, 2023.
- Letra e OEK dërguar Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave, Punës dhe
Transfereve, Ministrisë Industrië, Sipërmarrjes dhe Tregtisë, dhe Doganës së Kosovës. Tetor,
2023.
- Letra e OEAK dërguar Ministrisë së Shëndetësisë. Tetor, 2023.
- Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës. Ueb-faqja.
<https://www.amchamksv.org/membership-directory/membership-category/corporate/>.
- Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës. Ueb-faqja.
<https://www.amchamksv.org/membership-directory/membership-category/medium/>.
- Platforma e Konsultimeve Publike në kuadër të Qeverisë së Kosovës. Ueb-faqja.
<https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/40410-FinalAI.docx> .
- Letra e përbashkët e OEK dhe OEAK dërguar Ministrisë së Shëndetësisë. Nëntor, 2023.
- Intervistë me Dr. Faik Hoti, Zyrtar Përgjegjës i Grupit punues për hartimin e UA për Vërejtjet e
kombinuara. 25 tetor, 2023.
- Gazeta Kallxo.com. Betejë në Kuvend për Ekspozimin e Sërishëm të Duhanit. 21 prill, 2014.
<https://kallxo.com/gjate/beteje-ne-kuvend-per-ekspozimin-e-serishem-te-duhanit/> .
- Ekonomia.Info. Kundërshtohet ndryshimi në Ligjin për Kontrollin e Duhanit. 3 maj, 2014.
<https://ekonomia.info/sq/shendetesi/kundershtohet-ndryshimi-ne-ligjin-per-kontrollin-e-duhanit>.
- Ekonomia.Info. Industria e duhanit kundër Ligjit për kontrollin e Duhanit. 20 nëntor, 2012.
[Industria e duhanit kundër Ligjit për kontrollin e Duhanit - Industri - Ekonomia](http://ekonomia.info/sq/shendetesi/kundershtohet-ndryshimi-ne-ligjin-per-kontrollin-e-duhanit).
- Intervistë me Agim Shahini, Kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve. 10 nëntor, 2023.
- Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi Nr. 11/68. 9 tetor 2018.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62513> .
- Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi Nr. 11/64. 16 dhjetor, 2015.

- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62544> .
- Insajderi. Shfuqizohet vendimi për akcizën e duhanit me të cilin përfitonte Gazmend Abrashi. 2020.
<https://insajderi.com/shfuqizohet-vendimi-per-akcizen-e-duhanit-me-te-cilin-perfitonte-gazmen-abrashi/> .
 - Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi nr. 20/64. 11 shtator, 2018.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62509> .
 - Kallxo.com. Albin Kurti ndalon favoret për kompaninë e këshilltarit të Ramush Haradinaj. 28 shkurt, 2020.
[Albin Kurti ndalon favoret për kompaninë e këshilltarit të Ramush Haradinajt \(kallxo.com\)](https://kallxo.com/albin-kurti-ndalon-favoret-per-kompanine-e-keshilltarit-te-ramush-haradinaj/) .
 - Ekonomia Online. Qeveria shfuqizon vendimin që favorizonte ish-këshilltarin e Haradinajt. Viti 2020.
<https://ekonomiaonline.com/qeveria-shfuqizon-vendimin-qe-favorizonte-ish-keshilltarin-e-haradinajt/>
 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. KONCEPT DOKUMENTI PËR NDRYSHIMIN E POLITIKAVE FISKALE DHE BUJQËSORE PËR PRODHIMIN E DUHANIT DHE CIGAREVE NË KOSOVË. 1 gusht, 2018. Mund të gjendet në <https://www.mbpzhr-ks.net/sq/ligjet> .
 - <https://akk-ks.org/>
 - Agjencia Kundër Korrupsionit. Përgjigja në kërkesën e z. Glauk Konjufca për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Nr. protokollit 06-02/1348/19. 4 korrik, 2019.
 - Unioni i Gazetarëve Shqiptarë. Dritëro Agolli merr “Pendën e Artë” për gazetarinë. Paragrafi i pestë. 18 shkurt, 2017.
<https://unionigazetareve.com/index.php/2017/02/18/dritero-agolli-merr-penden-e-arte-per-gazetarine/>.
 - Gazeta “Epoka e Re”. Ndahen çmimet Vangjush Gambeta për gazetarinë ekonomike. 10 nëntor, 2023.
<https://www.epokaere.com/ndahen-cmimet-vangjush-gambeta-per-gazetarine-ekonomike/>.

Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC) është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2009 e përkushtuar për përmirësimin e cilësisë së jetës përmes informimit dhe fuqizimit të zërit të publikut në politikat shëndetsore, mjedisore dhe në proceset e vendim marrjes.

www.kadc-ks.org
info@kadc-ks.org

